

Data 22.02.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje ushqime per kopshtin dhe çerdhen”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Produkte ushqimore te ndryshme 15800000-6; Ushqim per femije 15884000-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,148,895 (kater milion e njeqind e dyzete e tete mije e teteqind e nentedhjete e pese) leke pa tvsh dhe 4,978,674 (kater milion e nenteqind e shtatedhjete e tete mije e gjashteqind e shtatedhjete e kater) leke me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Liçencë, kategoria II.1. A.1 “Per prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice te ushqimeve per njerez” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Shenim: Nuk lejohet perdorimi i licenses se nje operatori tjetër ekonomik (Rekomandim i përbashkët i APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, te LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e hapur të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: *Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik""Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".*

3. Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim, një automjet të pershtatshëm ATV (frigorifer), për të bërë transportimin e mallrave pranë kopeshtit dhe Cerdhës, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, të vërtetuar me dokumentacionin e duhur

tekniko-ligjor, leje qarkullimi, policen e sigurimit, certifikata e kontrollit teknik si dhe certifikate pronesie te mjetit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimineve për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqese **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ...”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Njesia e Prokurimit